



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **106**

Prishtinë, më 18.3.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi.

Munguan : Daut Haradinaj, Liburn Aliu, Boban Todorović, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.3.2013,
3. Shqyrtimi i planit për bujqësi dhe çështjeve rreth subvencioneve e granteve,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.3.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.3.2013 me vërejtjen e **Sevdije Lamës** se në diskutimin e saj në vend të fjalës “qëllimet e ligjit” duhet të jetë “qëllime ekonomike”.

3. Njoftimi nga Ministri Blerand Stavileci rreth çështjes së realizimit të granteve dhe subvencioneve në bujqësi

Kryetari Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrje Ministrin Stavileci dhe bashkëpunëtorët tjerë në MB (Ministria e Bujqësisë), fillimisht duke përkujtuar bashkëpunimin e fortë të këtij komisioni me zyrtarët e ministrisë së bujqësisë dhe duke kërkuar edhe kësaj radhe që të njoftohet komisioni më detalisht për çështjet aktuale në bujqësinë Kosovare, sidomos sa i përket ndihmesës që do të ofrohen fermerëve anekënd Kosovës, të cilët gjatë këtij viti do të kanë me siguri përkrahjen më të madhe financiare por në anën tjetër mungon informimi i tyre.

Ministri Blerand Stavileci gjithashtu konfirmoi dhe falënderoi për bashkëpunimin e lart që ka ky komision me ministrinë e bujqësisë, fillimisht njoftoi për materialin që është sjellur për komisionin dhe pohoi se sistemin e informimit në Kosovë nuk e kemi të zhvilluar, mirëpo MB nuk do të ndalet derisa të ofrohet shumë afër fermerit Kosovar në çdo aspekt, për ti ndihmuar rreth zhvillimit të bujqësisë duke u nisur nga bashkëpunimi me komuna, ngase ato ngecin në përcjelljen e ritmit të MB. Sugjeroi që ky komisioni të caktoj takimin ku do të ftohen bashkërisht MB dhe zyrtarët e Asoc. të Komunave për të sugjeruar disa rekomandime për mobilizim të mëtejshëm. Buxheti i sivjetshëm i MB bashkë me atë të Bankës Botërore dhe projektit Danida është 27 milion, ndaj shprehu optimizmin se fermerët do të ndihmohen edhe më mirë se vitet e kaluara. Në materialin për këtë mbledhje, ai tha se janë sqaruar detalisht sektorët bujqësor të cilat trajtohen në MB dhe ndikojnë kontributet e ministrisë, mirëpo kjo nuk mjafton për vetëkënaqësi, ndaj në vijim pritet një master plan që do të tejkaloi kompetencat e MB. Programi i MB si tha ai ndahet në dy pjesë, pagesa e subvencioneve dhe grantet, njëherit në mënyrë tabelare tregoj për gjendjen aktuale dhe risit, ku më së miri qëndron puna me qumësht. Ai njëherit verifikoi se grantet kanë prodhuar efekte duke krijuar vende të reja të punës (mbi 2100 vende), por edhe risia tjetër se fermerët dhe agrobiznesi mund të drejtohen edhe në banka të cilët mund të kreditohen deri në 7%. Në vazhdim ai njoftoi për selinë e Agjencisë për pagesa (afër gjimnazit Sami Frashëri) ku çdo fermer mund të afrohet për çfarëdo lloji informate rreth subvencioneve dhe granteve, mirëpo potencoi faktin e cekur nga **Kryetari** (rrugët e dobëta bujqësore) e cila pengon zhvillimin e bujqësisë madje edhe nëse pesëfishohen subvencionet, si dhe nëse kemi parasysh faktin se ky sektor ka qenë shumë e nënvlerësuar, ndaj është dashur që MB të nisët nga e para. Nëse realizohen disa synime për vitet 2014-2020 dhe që Kosova të trajtohet si e përvetshme, IPA 2 do të ndihmoi edhe vendeve që nuk kanë statusin e kandidatit, përfundoi.

Kryetari Nait Hasani falënderoi dhe inkurajoi për rezultatet që synohen në MB ngase çdo gjë varet nga ajo sa avancohet bujqësia nga Qeveria e cila ka shpallur bujqësinë si prioritet. Ai pyeti për kompanitë e sigurimit sa munden me marr përgjegjësinë për këto obligime që u than, sa do të realizohen obligimet nga Ligji për kooperativat për të ndihmuar fermerët rreth TVSH (qumështi etj). **Rasim Demiri** pyeti rreth subvencioneve për ferma të pulave për këtë vit (ministri u përgjigj se ato kanë filluar dhe ende nuk ka kaluar afati për aplikim). **Afërdita Berisha** pyeti rreth politikave të MB rreth buxhetit nëpër komuna, a është fjala për mungesë apo bëhet fjalë për defekte komunale, gjithashtu pyeti për parashikimet e fatkeqësive pse nuk bëhen ngase ato ndodhin si dhe grantet për bujqit sa shfrytëzohen dhe a kthehen nëse nuk shfrytëzohen, dhe në fund publikimi rreth aflatoksinës së qumështit. Ministri u përgjigj fillimisht për pagesat që bëhen sipas planit prej fillimit të tenderimit të farës e me radhë, dhe shtoi se këto informata gjenden brenda komunave të caktuara, ndërsa lidhur me fatkeqësitë ai tha se MB ndan fonde por ato janë më tepër individuale, për këtë arsye ato duhet të trajtohen bashkërisht në kuadër të rezervave ku zgjidhja afatgjatë është siguri. Për grantet e joshfrytëzuara ai tha se ato kthehen, ndërkaq Drejtori për pagesa **Elhami Hajdari** vazhdoi edhe me disa sqarime shtesë rreth realizimit të subvencioneve për të cilat janë paraparë 15 hapa deri te realizimi-përfitimi, ndërsa deri tani janë kontrolluar 180 lëndë. Maqedonia dhe Serbia, vazhdoi, kanë përafërsisht nga rreth 200 milion mjete financiare për subvencione, ndërsa Kosova bashkërisht me Shqipërinë kanë 26 milion, që flet qartë sa duhet të kemi parasysh rreth syqeltësisë. **Nijazi Idrizi** kryesisht u pajtua me referimet e zyrtarëve të MB mirëpo konstatoi se duhet një ristrukturim në MB ngase nuk është

çdo gjë në rrugën e duhur, koordinimi me komunat duhet të rritet, subvencionet dhe grantet duhet të jenë prioritare, të investohet në ujitje të tokave ngase pa të nuk ka bujqësi, pra të vendoset si çështje primare sidomos nëse kemi parasysh ngrohjen globale me rastin e humbjes së lagështisë së tokës në muajt para se të filloi vera, në anën tjetër Ibër Lepenci nuk po arrin të kryej funksionin që ka, qendrat grumbulluese duhet të jenë me karakter të stabilizimit, të subvencionohet prodhimi i venës e jo mbjellja e vreshtave, kjo ja vlenë për shkak se kemi mikroklimën e duhur, por jo të del jashtë Kosovës vena me 15 cent por me një çmim dinjitoz, si tha ai 2 euro, sikurse gjithkund në Evropë. **Ministri** tha se janë kuotat e caktuara, megjithatë përgjigje për këto çështje do të kemi në janarin e vitit 2014, lidhur me venë shtoi se për këto gjëra se çka avancohet e çka jo ka mjaft dilema (vreshtarët apo vertarët), megjithatë konstatoi se duhet të kemi bashkëpunim të mirë, ngase ka edhe degë tjera siç është pemëtaria (molla etj), nuk mundet të ndahet zhvillimorja dhe socialja sikurse me thikë kur prehen gjërat, përfundoi. **Afërdita Berisha** reagoi rreth venës dhe tha se dyjat duhet të përkrahen ngase janë në ndërlidhje. **Sevdije Lama** pyeti a do të ketë trajnime për kategorinë e fermerëve të pashkolluar, a ka dëshmi se toka në Kosovë është jo e helmuar dhe për Gjakovën përkatësisht fabrikën e lëngjeve sa mundet MB të ndikoi në AKP rreth ridestinitimit pas privatizimit dhe sa mundet të mbrohet ajo, në mënyrë që mos të degradohet ajo. Kryetari i Komisionit parashtroi edhe disa pyetje në emër të **Liburn Aliut** i cili nuk ishte prezent në mbledhje, rreth subvencioneve në mallra dhe shërbime, për 4 pika të grumbullimit dhe rrugët fushore, Ligjin e pyjeve i cili duhet të sjellët më heret në Kuvend, penda e Ibrit etj. Drejtori për pagesa në vazhdim u përgjigj rreth ngritjes së një sistemi të mirëfillt të ujitjes të cilën e ndanë kanali në mes Prelluzhës i cili duhet patjetër të ndryshoi, ndërsa sa i përket Ligjit për tokën bujqësore, askush nuk ka marr përgjegjësinë për gabimet e bëra nga kryetarët e komunave (kryetari Nait Hasani). Ministri vazhdoi sa i përket shërbimeve këshillimore të cilat do të jenë dy lloje, farmer dhe trajner të fermerëve plus zyrtar komunal të avancuar, ndërsa për tokën e helmuar kompetente është MMPH mirëpo si tha ministri MB mori bajrakun dhe konstatoi që nuk ka helmim të tokës në Kosovë, së paku nuk u vërtetua se dikush ka pësua me helmim. Në lidhje me pyetjen e Sevdije Lamës, ministri premtoi se do të angazhohet për brengosjen që shfaq ajo lidhur me fabrikën në fjalë. **Kryetari Nait Hasani** në fund falënderoi dhe premtoi mbështetje për MB.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani